



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 144/14 Prot.

Tiranë, më 4/7 /2013

Lënda: Rekomandim për "IDRA Research & Consulting", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 09, datë 04/07/2013

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "IDRA Research & Consulting", Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 15/05/2013, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit ka përfunduar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, "IDRA Research & Consulting", Tiranë me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

1. Objekti i kontrollit:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale prej kontrolluesit "IDRA Research & Consulting" Sh.p.k., Tiranë, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "I anketuar":**
 - Verifikimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale, bazuar në nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe, Vendimit Nr.2, datë 10.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre", si dhe Udhëzimit nr.6, datë 28.05.2010 "Mbi përdorimin korrekt të SMS-ve, për qëllime promovionale, reklama, shitjeve direkte, nëpërmjet telefonisë celulare" në lidhje me:
 - Verifikimin nëse të dhënat e kategorisë "Anketues", përpunohen edhe për qëllim "Anketimi/Sondazhe", apo dhe qëllime të tjera;
 - Verifikim i kategorive të të dhënave që përpunohen;
 - Mënyrat e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit, përhapjes dhe transferimit të të dhënave;

- Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
- Saktësinë dhe përditësimin e të dhënave që përpunohen;
- Kohën e ruajtjes së të dhënave personale që përpunohen;
- Përhapjen e të dhënave të mbledhura e të përpunuara, tek të tretët;
- Transferimin ndërkombëtar të këtyre të dhënave;
- **Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave "Anketues", bazuar në nenet 6/a, "Pëlqimi" dhe 18, (Detyrimi për informim), të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, në lidhje me:**
 - Informimin e subjekteve të të dhënave që ju mblidhen dhe ju përpunohen të dhënat personale dhe marrja e "pëlqimit";
 - Rastet, nëse kontrolluesit i është kërkuar nga subjekti i të dhënave përmbushja e të drejtës për akses në përpunimin e të dhënave personale, si dhe nëse është kërkuar korigjimi ose fshirja e këtyre të dhënave.
- **Siguria dhe politikat e privatësisë për përpunimin e të dhënave "sensitive", bazuar në nenet 20, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në lidhje me:**
 - Caktimin e ndonjë përpunuesi të të dhënave sensitive dhe mbi çfarë akti ligjor;
 - Vendosjen e kontrollit në aksesin e të dhënave sensitive të përpunuara dhe përgjegjësitë në administrimin e këtyre të dhënave;
 - Nivelin e sigurisë fizike dhe teknike të sistemit të përgjithshëm ose të veçantë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale;
 - Verifikimin, nëse ka në fuqi ndonjë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme;
 - Verifikimin, nëse janë parashikuar dhe zbatohen politikat e mbrotjes së të dhënave nëpërmjet "konfidencialitetit".

Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast, si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi "IDRA Research & Consulting" është një kompani e specializuar në fushën e kërkimeve të tregut dhe këshillimit të biznesit me zyra në Shqipëri dhe Kosovë. Kompania ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 si një njësi kërkimore pranë Institutit për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi. Më vonë ajo mori statusin e një kompanie (sh.p.k.). IDRA sh.p.k ende vazhdon t'i shërbejë Institutit në studimet social-ekonomike që ai realizon. IDRA është anëtare e Shoqatës Evropiane të Profesionistëve në Kërkimet Marketing dhe Opinioneve (ESOMAR), dhe i qëndron bindshëm kodeve dhe standardeve të saj. Konstatohet se IDRA Research & Consulting trajnon stafin sipas standardeve Ndërkombëtare në fushën e kërkimit në treg, konsumatorë dhe shoqëri.

IDRA përbëhet nga dy departamente operacionale që mbështesin dhe ndihmojnë njëri-tjetrin: **IDRA Research** ofron një llojshmëri shërbimesh të kërkimit të tregut, si sasiore ashtu edhe cilësore, për klientë privat dhe institucionalë.

IDRA Consulting - ofron një seri shërbimesh konsulence në fushat:

- i) Konsulencë mbi Çështje të Zhvillimit,
- ii) Analizë të Konkureshmërisë,
- iii) Analizë e Përgjithshme e Ekonomisë dhe Sektoriale (Analiza të Industrisë),
- iv) Strategji Marketingu,
- v) Shërbime të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për bizneset, etj.

IDRA Konsulencë ka asistuar një numër kompanish private apo institucione. IDRA Konsulencë publikon në mënyrë periodike raporte rreth studimeve që kryen.

Përpunues të dhënash & Analist

IDRA Research & Consulting për përmbushjen e misionit të saj punëson punonjës në pozicionin *“Përpunues të dhënash (operator) dhe Analist”*.

Detyrat kryesore të një përpunuesi të dhënash (operatori) janë:

- Analizimi i të dhënave të mbledhura prej hulumtimeve të tregut, duke përdorur metodika dhe programe statistikore
- Krijimi i platformave të hedhjes dhe verifikimit të të dhënave vizuale e të dhënave nëpërmjet grafikëve, tabelave etj
- Prezantimi i të dhënave me gojë në formë të shkruar, diskutimi etj
- Shpjegimi dhe argumentimi i rezultateve
- Ndhimesa për drejtuesit e kompanisë për të paraqitur gjetjet e hulumtimeve në një mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për klientët

Për ç’do punonjës të ri, i cili përzgjidhet nga konkurentët e mundshëm, nënshkruhet një kontratë punësimi nga të dy palët (punëdhënës-punëmarrës) në të cilën janë të përshkruara:

- Qëllimi i kontratës
- Puna që do të kryhet
- Kohëzgjatja e kontratës
- Listë e dokumentave të cilat nevojiten për kandidatin
- Konfidencialiteti

Së bashku me lidhjen e kontratës së punës, punëmarrësi nënshkruan edhe një **“Marrëveshje Konfidencialiteti”**, në të cilën përcaktohen detyrime dhe përgjegjësitë në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit dhe sekretit profesional. Sipas kësaj marrëveshjeje, në kuptim dhe në funksion të saj, **“Informacion Konfidencial”**:

“nënkupton çdo lloj informacioni të marrë nga punonjësit e IDRA sh.p.k, që përfshin deklarinimin qëllimit të vërtetimit edhe në informacionin tjetër, që ajo merr për realizimin e projekteve nga klientët privatë metë cilët ka kontrata, në lidhje me QELLIMIN. Informacion

konfidencial konsiderohet dhe informacioni mbi t ëdhënatpersonale të personave të ndryshëm që intervistohen”.

Konstatohet se punonjësit e rinj trajnohen dhe pajise me “Manualin e intervistuesit”. Në këtë manual janë përcaktuar qartë mënyrat dhe procedurat e punës për punonjësin intervistues. Pjesë e këtij manuali është edhe rubrika 4.3 e cila lidhet me ruajtjen e konfidencialitetit referuar të dhënave me të cilat intervistuesi vihet në dijeni për shkak të detyrës.

Kontrolluesi “IDRA Research & Consulting” disponon “Manual Personeli i Punonjësve të IDRA Research & Consulting”. Ky manual, përveç të tjerash, përmban në mënyrë të qartë referimin e ligjit nr. 9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kontrolluesit “IDRA Research & Consulting” disponon gjithashtu edhe “Kodin Etik” të kompanisë rubrika të së cilës janë edhe parimet themelore si integriteti, profesionalizmi, ndershëmria, përgjegjshmëria, konfidencialiteti etj.

Kontrata me palë të treta

Konstatohet se, kontrolluesi “IDRA Research & Consulting”, nuk delegon procese të aktivitetit të saj drejt palëve të treta.

Gjithashtu konstatohet se, kontrolluesi “IDRA Research & Consulting”, nuk realizon transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, të anketuesve, dhe as të punonjësve të saj, qofshin këta me kohë të plotë apo me kohë të pjeshme.

Kontrata me klientët

Klientë të kontrolluesit “IDRA Research & Consulting” janë institucione publike ose private të cilat lidhin kontrata shërbimesh në funksion të kërkimit të tregut, si sasiore ashtu edhe cilësore, për klientë privat dhe institucione të ndryshme. Kontrolluesi “IDRA Research & Consulting” realizon kërkim dhe studim tregu në forëm sondazhi me subjekt psh.: “matja e nivelit të kënaqësisë së klientit X”. në kontratë konstatohet të jenë të përcaktuara afatet e ruajtjes së të dhënave të mbledhura nga kontrolluesi IDRA, shkatërrimi mbas mbarimit të këtij afati, ruajtja e fshehtësisë dhe konfidencialitetit në lidhje me të gjitha materialet dhe të dhënat e grumbulluara dhe përpunuara që kanë lidhje me studimin e tregut.

Metodologjia e intervistimit

Metodat e përdorura përfshijnë intervistat ballë për ballë, CATI, CAËI, grupe të fokusuara, intervista në thellësi, testim produktesh, mystery shopping, etj. Rrjeti i intervistuesve të IDRA-s përfshin më shumë se 250 vetë duke mbuluar të gjithë territorin e Shqipërisë. Intervistuesit janë të punësuar me kohë të pjeshme në varësi të rastit studimor.

Kërkimi

Ndërsa kërkimi sasior lidhet më shumë me pyetje të tilla si: Sa shumë? Sa shpesh? Në ç’përmasa?, Kërkimi Cilësor lidhet me gjetjen e përgjigjeve Pse? Si? Në ç’mënyrë? Kërkimi cilësor përdoret kur kërkesa e klientit (biznesit) ka nevojë të njohë në thellësi disa nga çështjet e mëposhtme:

- Kuptimi i procesit të vendim-marrjes për blerjet;
- Njohja e nevojave dhe preferencave për produktet dhe shërbimet;
- Identifikimi i anëve të forta, atyre të dobëta, si edhe mundësive të biznesit;
- Vlerësimi i efikasitetit apo testim paraprak i reklamave/ strategjive të marrëdhënieve me publikun;

- Analiza dhe njohja e qëndrimeve, sjelljeve dhe qëllimeve të njerëzve;
- Eksplorimi i pozicionimit të markës;
- Testimi i ideve apo koncepteve të produkteve të reja;

Disa nga çështjet e marketingut për të cilat IDRA ka realizuar kërkime cilësore janë:

- Pozicionimi i markës;
- Perceptimi mbi çmimet;
- Studim i reklamës dhe menyrës së komunikimit;
- Testim koncepti;
- Studim i ambalazhimit dhe paraqitjes grafike;
- Analizë e sjelljes konsumatore;
- Testim produkti, etj.;

SHEMBULL: “VROJTIMI “OMNIBUS ALBANIA” ,

1000 intervista në të gjithë Shqipërinë

Çdo muaj !

Çfarë është Vrojtimi Omnibus?

Vrojtimi Omnibus është një mënyrë vrojtimi i popullatës kur kërkon një informacion të shpejtë dhe me kosto të ulët në lidhje me opinionet, tregun, produktet apo shërbimet, etj. Vrojtimi drejtohet duke përdorur një pyetësor i cili përmban rreth 8 pyetje kategorizuese për të intervistuarin, ndërsa pjesa tjetër e pyetësorit rezervohet nga kompanitë ose institucionet për pyetjet e tyre specifike.

Në këtë mënyrë, vrojtimi Omnibus është një mundësi për kompaninë apo institucionet për të rezervuar pyetjet e tyre, pa pasur nevojën që të organizojnë një kërkim tregu apo sondazh opinionit të plotë, i cili do t’u kushtonte më shumë.

IDRA Kërkim realizon periodikisht “*Omnibus Albania*” me 1,000 familje në të gjithë Shqipërinë (duke bërë përzgjedhje rastësore).

Duke qenë se kryhet çdo muaj, ky vrojtim me kampion Kombëtar është një mënyrë e mirë për kompanitë apo institucionet për të marrë informacion në mënyrë periodike mbi ecurinë e produktit, shërbimit apo efektin e reklamës përveç shumë informacioneve të tjera si:

- Profilet e përdoruesve të produkteve ose shërbimeve
- Nivelin e informimit mbi një produkt apo shërbim
- Imazhin e një kompanie apo institucioni
- Faktorët në përzgjedhjen e një produkti apo shërbimi
- Qëndrimin e konsumatorit për produktet dhe shërbimet
- Dhe shumë informacione të tjera sipas nevojave të klientit

Të gjitha pyetjet e rezervuara dhe përgjigjet e tyre janë e drejtë ekskluzive e kompanisë ose institucionit që i rezervon ato.

Metoda e vrojtimit është ajo e intervistës ballë për ballë, bazuar në përzgjedhjen rastësore të familjeve duke përdorur metodogjinë e *Rrugës Rastësore* (dera e tretë, personi me ditëlindjen

më të afërt). Metoda siguron përfaqësimin e saktë të shembullit. Gjithashtu, kontrolli kryhet edhe me kuotat e përfaqësimit.

Rezultatet e paraqitura përmes grafikëve dhe një raporti vihen në dispozicion në një kohë të shkurtë dhe me cilësi (brenda 4 javësh nga data e nisjes së vrojtimin). Rezultatet për pyetjet që klienti ka rezervuar kryqëzohen me 8 pyetjet bazë. Duke shfrytëzuar periodicitetin e "Omnibus Albania", klienti mund të gjykojë mbi rezultatet e strategjive të veta, të marketingut, mbi produktet apo shërbimet.

Shembull 2

1. Sondazh i banorëve

IDRA kreu një sondazh prej 200 intervistash për të matur opinionet e banorëve të Bashkisë Pogradec në lidhje me tema si transparenca, shpërndarja e fondeve, niveli i pjesëmarrjes dhe të tjera. Më specifikisht qëllimi i anketës ka të bëjë me çështje si:

- Niveli i njohjes së banorëve 2 për buxhetin e bashkisë
- Niveli i njohjes së banorëve për procesin e buxhetimit (kur kryhet, kush janë palët e përfshira, kush mund të marrë pjesë dhe të tjera)
- Gatishmëria e banorëve për të marrë pjesë në proces
- Sa të kënaqur janë banorët me buxhetet e vitete të mëparshme
- Mendime se cilave funksione/shërbime duhet tu shpërndahen më shumë fonde
- Mendime se sa mirë buxheti reflekton nevojat e banorëve
- Mendime rreth transparencës së procesit të buxhetimit

1.1 Metodologjia

Metoda e kampionimit me "kluster" u përdor për përzgjedhjen e pikave të kampionimit për këtë sondazh. Qendrat e votimit shërbyen si njësi primare të kampionimit (NPK). Territori gjeografik i bashkisë u nda në fillim në njësi gjeografike të cilat përputhen me shtrirjen gjeografike të qendrave të votimit 3. Kjo ndarje është gjithëpërfshirëse (d.m.th i gjithë territori i bashkisë u mbulua) dhe ekskluzive (çdo dy qendra votimi nuk kanë mbivendosje në territorin e tyre gjeografik).

Proçesi i përzgjedhjes së të intervistuarve u përbë nga tre etapa:

Etapa 1: Përzgjedhja e NPK/QV

IDRA ka në përdorim listën e qendrave të votimit të bëra publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Lista e qendrave të votimit të Bashkisë Pogradec u ruajt në një bazë të dhënash. Kjo listë shërbeu si universi i qendrave të votimit. Dyzet (40) qendra votimi u përzgjedhën në mënyrë rastësore nga universi i qendrave të votimit. Algoritmi i përdorur për përzgjedhjen e qendrave të votimit ishte përzgjedhje rastësore e thjeshtë pa përsëritje. Çdo qendër votimi në univers kishte një mundësi të barabartë përzgjedhjeje. Në rast se përzgjidhej një herë një qendër votimi nuk mund të përzgjidhej për herë të dytë.

Etapa 2: Përzgjedhja e banesës

Intervistuesit iu caktua një pikë reference/pikë fillimi, që në përgjithësi ishte vetë qendra e votimit 4 ose një ndërtesë e njohur, një kryqëzim rrugësh, shkollë, institucion publik etj. në zonën e qendrës së votimit. Mbasi mbërrinte në pikën e referencës/fillimit, intervistuesi i kthente shpinën kësaj pike dhe fillonte të ecte duke mbajtur gjithmonë anën e djathtë. Intervistuesi u udhëzua të numëronte banesat që kalonte dhe të përpiqej të kryente intervistë çdo banesë të tretë të numëruar.

Etapa 3: Përzgjedhja e respondentit

Mbasi përzgjidhej banesa, intervistuesi merrte të gjitha ditëlindjet e banorëve të përhershëm mbi 18 vjeç të saj. Banori i përhershëm i banesës i cili/e cila kishte festuar ditëlindjen më pranë ditës së intervistës u përzgjidh për tu intervistuar. Vini re se vetëm ky respondent kishte të drejtë të intervistohet. Nëse respondent i refuzonte të merrte pjesë në sondazh, banesa kategorizohej si refuzim dhe banesa tjetër e përzgjedhur (duke ndjekur hapin) kontaktohej për intervistë. Nëse respondent i nuk ndodhej në banesë në momentin që intervistuesi kontaktonte me banesën, intervistuesi duhej të përpiqej të kontaktonte me respondentin e përzgjedhur të paktën edhe tre herë të tjera përpara se ta kategorizonte shtëpinë si refuzim.

1.2 Përfundime

Rezultatet e sondazhit janë paraqitur fillimisht në formë grafike, të ndjekura më vonë nga të gjitha shpjegimet përkatëse. Një kampion prej 200 intervistash ka një marzh gabimi të konsiderueshëm (marzhi i gabimit është $\pm 7\%$ me një interval besimi prej 95%). E thënë ndryshe sondazhi ka 95% mundësi për të parashikuar parametrat e vërtetë të popullsisë (banorëve të Pogradecit) brenda marzhit të gabimit. Kur krahasohen ndryshimet ndërmjet përqindjeve marzhi i gabimit ndryshon, dhe për të arritur në rezultate statistikisht domethënëse, IDRA ka kryer edhe testet statistikore përkatëse. Rezultatet e tyre janë paraqitur vetëm kur ato kanë qenë statistikisht domethënëse.

Qëllimi i Përpunimit të të dhënave të anketuesve

Nuk konstatohet se të dhënat e kategorisë “*I anketuar*” përpunohen për qëllime të tjera përveç se statistikore. Nga konstatimet e bëra në raportet përfundimtare të studimeve/anketimeve konstatohet se nuk ka përmbajtje apo referenca lidhur me persona të identifikueshëm. Konstatohet gjithashtu se për “*klientin*” realizohet një prezantim rreth studimit por në këtë prezantim nuk paraqiten të dhëna personale të të anketuarve.

Konstatohet se në sistemin informatik “*IBM SPSS data editor*” (sistem i cili përdoret për analiza dhe qëllime statistikore) baza e të dhënave është e ruajtur në dy tabela të veçanta. Tabela e parë është e përbërë nga tre kolona ku:

- Kolona e parë përmban kodin identifikues të personit të anketuar;
- Kolona e dytë përmban “*emër*” dhe “*mbiemër*” të personit të anketuar;
- Kolona e tretë përmban numrin e telefonit të personit të anketuar;

Tabela e dytë përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të realizuar studimin dhe analizën e këtij sondazhi. Konstatohet se në tabelën e dytë kolona e parë ka si përmbajtje kodin identifikues të të anketuarit. Për të bërë identifikimin e të anketuarit është e nevojshme të dihet me saktësi se cilit “*emër*” i referohet “*kodi*” përkatës.

Konstatohet se tabelat janë të ndara nga njëra tjetra dhe në vend-ndodhje të ndryshme.

Kategoritë e të dhënave që përpunohen

Per sa kontrolluesi “IDRA Research & Consulting” është e specializuar në fushën e kërkimeve të tregut dhe këshillimit të biznesit, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së vet mbledh, përpunon dhe për këto arsye kontrollon të dhëna personale të aplikantëve. Kategoritë e të dhënave variojnë në varësi të studimit për të cilin është kontraktuar. Konstatohet se kontrolluesi “IDRA Research & Consulting” përveç të dhënave të përgjithshme si:

- Emër mbiemër
- Qendra e votimit
- Adresa
- Karakteristika rreth vendit të punës
- Mosha (përafërsisht)
- Nëse ka llogari në facebook
- Statusi civil
- Niveli arsimor
- Të ardhurat

Mbledh, përpunon dhe për këto arsye edhe kontrollon të dhëna sensitive si:

- Përkatësinë fetare
- Jeta seksuale
- Bindje politike

Kategoritë e të dhënave që përpunohen për kategorinë punonjës

Kontrolluesi mbledh, përpunon dhe për këto arsye kontrollon të dhëna rreth punonjësve të cilët i rekruton për të ushtruar veprimtarinë e vet. Të dhënat e punonjësve regjistrohen në një sistem informatik për burimet njerëzore.

Kategoritë e të dhënave të cilat ruhen për çdo punonjës janë:

- Emër Mbiemër
- Kodi i identifikimit
- Koha e fillimit të punës
- Statusi aktiv/i larguar/i përjashtuar
- Ditëlindja
- Gjinia
- Vendndodhja
- Shënime
- Kontakte / adresa e banimit / e-mail, telefon
- Kualifikime / gjuhë të huaja

- Kodi i bankës

Nga ky kontroll u hartua dhe proces verbali përkatës që mban datën 21.05.2013, dhe u dorëzua në datë 28.05.2013

Përshkrimi i shkeljeve administrative.

Gjatë kontrollit administrativ u konstatuan se, ka shkelje të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

1-Kontrolluesi, “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, ka shkelur nenin 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar duke mos njoftuar sipas kërkesave të këtij ligji;

2- Kontrolluesi, “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, ka shkelur nenin 6, germa “a” dhe nenin 3, paragrafi 24, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2013, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duke mos aplikuar mekanizmin e “Pëlqimit”, për subjektet e të dhënave, për kategorinë “i anketuar”;

3- Kontrolluesi, “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, ka shkelur nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duke mos informuar subjektin e të dhënave personale, në formë të shkruar.

Pretendimet e kontrolluesit.

- 1- “Se pari, konsiderojme se Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ka marrë parasysh në pikat e konstatuara, rastin specifik të Kerkimeve të Tregut dhe Opinionit. Fryma e ligjit duhet të pershtatet sektorit specifik. Në shpresojmë se vizita juaj në kompaninë tone do të shërbejë për të krijuar një precedent pozitiv dhe një procedure specifike përsa i përket industrisë së kerkimeve të tregut. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me ju për të krijuar një praktike sa më të qarta ligjore dhe procedurale për të gjithë sektorin tone.

Si rezultat kontrollit të sipërpermendur grupi i inspektimit ka konstatuar se:

1. **Kontrolluesi nuk aplikon mekanizmin e Pelqimit për subjektet e të dhënave Personale për kategorinë intervistuar duke shkelur nenin 6, pika 1, germa a, të ligjit Nr. 9887, dt 10/3/2008 “Për mbrojtjen e të dhënavepersonale” indryshuar.**

Dhënia e pelqimit jepet me deklarate gojore dhe është një element pa të cilin nuk mund të zhillohet intervista duke qenë se ato të gjitha realizohen balle për balle. Marrja e pelqimit me shkrim sic pretendon grupi i kontrollit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke shënuar emrin, mbiemrin dhe firmën e personit të intervistuar do të linte gjurmë të cilat do të rrezikojnë ceshtjen e konfidencialitetit. Kjo procedure do të ishte tejte e rrezikshme dhe me demë të pallogaritshme për industrinë e kerkimeve të tregut sepse do të demtonte drejtpërdrejt besimin e të anketuarve duke “synuar” lidhjen e emrit të personit me ato çfarë ai ka shprehur në një formë të drejtpërdrejtë. Nuk ekziston asnjë precedent në asnjë nga shtetet me të zhvilluara të botes ku për ceshtje anketimi tregu/opinionit të natyres së punës sone të kerkohet deklarata me shkrim nga ana e të anketuarve. Kjo është konform frymës së si duhet të interpretohet legjislacioni shqiptar për ceshtjen e dhënies së pelqimit, ESOMAR dhe legjislacionit të të gjitha shteteve të bashkimit europian. Edhe njëherë e përsërisim, që marrja me shkrim e firmës së të anketuarit, nuk ekziston në asnjë **praktike të kerkimeve të tregut** në bote. (Ju lutem konsideroni

edhe metodat e tjera te kerkimit te tregut sic do te ishte anketa me telefon edhe eeb, qe e ben te pamundur marrjen e firmes se te intervistuarit).

Marrja e pelqimit jepet me deklarate gojore, ku qe ne momentin e prezantimit, i intervistuari merr informacion mbi personin qe po e interviston, merr informacion per kompanine IDRA, merr informacion mbi qellimin e anketimit, per konfidencialitetin e te dhenave dhe faktin se ai eshte perzgjedhur ne menyre rastesore, se pergjigjet e dhena ne kete pyetesor do te perpunohen dhe perdoren per qellime analitike dhe se asnje e dhene identifikuese e tij nuk do te lidhet me mendimin e shprehur (nese i kerkohet firma e gjitha kjo bie poshte). Te intervistuarit i thuhet qe ai ka te drejte ta nderpresesi intervisten ne cdo moment ose te mos i pergjigjet cilesdo nga pyetjet e drejtuar. **Intervistuesi e pyet te intervistuarin nese mund te filloje me intervisten dhe vetem pas marrjes se aprovimit te tij mund te vazhdohet me tej!** Pra pas nje informacioni te detajuar, i intervistuari vendos nese do te vazhdoje tu pergjigjet pyetjeve tona apo do te refuzoje.

Me poshte po japim nje model se si behet marrja e pelqimit per realizimin e intervistes:

Miredita! Une quhem _____ dhe punoj per nje kompani kerkimesh tregu qe quhet IDRA. Ne jemi duke kryer nje anketim per ceshtje te _____ dhe deshirojme te kryejme nje interviste me ju. Ju garantoj qe informacioni qe do te ndani me ne eshte teresisht konfidencial. Emri juaj nuk do te shfaqet ne asnje dokument te lidhur me kete ankete. Pergjigjet tuaja do te perpunohen dhe do te perdoren per qellime analitike. Do t'ju ishim shume mirenjohes nese do te na kushtonit pak nga koha juaj per t'ju pergjigjur disa pyetjeve qe ne kemi pergatitur per kete anketim. Keni te drejte te mos merrni pjese ne kete ankete dhe te drejten per te nderprere intervisten ne cdo moment, ose te mos i pergjigjeni cilesdo pyetje te drejtuar. A keni ndonje pyetje? A mund te fillojme me intervisten? Faleminderit!

2. Kontrolluesi IDRA Research and Consulting nuk i informon subjektet e te dhenave personale duke shkelur nenin 18 te ligjit Nr. 9887, dt 10/3/2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale" i ndryshuar.

Ky pretendim nuk qendron dhe nuk e kuptojme se si ka arritur zyra e komisionerit ne nje konstatim te tille. Sepse intervistuesit e IDRA i informojne te intervistuarit (subjektin e te dhenave) (shiko pasazhin me siper):

- ✓ Qe informacioni i marre prej tyre eshte teresisht konfidencial dhe nuk do i shpaloset asnje pale te trete. Kjo eshte pergjegjesia e drejteperdrejte e IDRA.
- ✓ Nuk do te behet lidhja e emrit te tyre me mendimin e shprehur.
- ✓ Pergjigjet e tyre do te perpunohen dhe perdoren per qellime analitike ne forme agregate dhe ASNJEHERE NE FORME INDIVIDUALE.
- ✓ Informohen per qellimin e studimit. Pra i **thuhet** (bold-imi dhe nenvizimi i fjalës "thuhet" është kryer nga inspektori, për të theksuar formën, se si informohet subjekti i të dhënave personale), qe kjo interviste po behet per kete qellim, sic mund te jete p.sh *do te ndikoje ne permiresimin e ligjeve dhe procedurave tatimore ne menyre qe tju ndihmoj ejuve te kurseni kohe dhe para duke lehtësuar operacionet e përditshme dhe procedurat sipas legjislacionit tatimor.*
- ✓ I jepet informacion nga intervistuesi per IDRA, qe eshte nje kompani shqiptare me qender ne Tirane, fare eshte, me fare merret dhe per me shume ata mund ridrejtohen faqes se

internetit www.idra.al si dhe mund te kontaktojne ne numrat e telefonit (cdoAnketues I IDRA ka nje karteidentifikimi te vendosur ne vend te dukshem).

- ✓ I jepet mundesia qe te pyesi per cdo gje per parafillimit te intervistes.

Nje gje e tille del e qarte ne ICC/Kodin Nderkombetar te ESOMAR per kerkimet e tregut dhe sociale, **neni 4 – Transparenca** ku thuhet se *a) Kerkuesit duhet te identifikojne qarte veten e tyre dhe te tregojne qellimin e kerkimit. b) I intervistuari duhet te jete ne gjendje qe te kontrolloje lehtësish identitetin dhe mirebesimin e kompanise se kerkimit.*

3. Kontrolluesi IDRA Research and Consulting nuk parealizuar detyrimin per Njoftim dhe perben shkelje sipas nenit 21 dhe 22 te ligjit Nr. 9887, dt 10/3/2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale” indryshuar.

IDRA Research and Consulting ka arsyetuar se nuk duhet te konsiderohet si subjekt qe perpunon te dhena personale sipas perkufizimit te ligjit.

- ✓ Asnje informacion identifikues i te anketuarve nuk lidhet me pyetjet qe i jane bere ne nje projektspecifik.
- ✓ Asnje informacion idetinfikues nuk qendron i grumbulluar me vete per qëllimet e tjera dhe cdo informacion qe mund te krijoje premisa identifikuese shkaterrohet pas perfundimit te cdo projekti. Asnje informacion identifikues nuk percillet per asnjë arsyë tek asnje pale e trete.
- ✓ Te intervistuarit zgjidhen siperfaqesues te njekampioni ne nje forme teresisht rastesore me baze gjeografike (jo me lista identifikuese) dhe te dhenat e tyre perpunohen per kërkime shkencore ose statistikore.
- ✓ Te dhenat per te intervistuarit jane konfidencialedhe programet statistikore jane te tilla qe nuk e lidhin emrin e personit me pergjigjen e dhene prej tij.
- ✓ Te gjitha pyetjet jane te koduara.

Pra asnje e dhene personale nuk ruhet ne asnjë forme historike dhe/apo forme tjeter.

IDRA ne perputhje me udhezimet e ESOMAR, argumenton se kërkimet kane nje status te veçante qe i dallon ato nga aktivitetet e marketingut tregtar dhe duhet te përjashtohen nga pergjegjësia per te njoftuar sipas **nenit 21 dhe 22 te ligjit Nr. 9887, dt 10/3/2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale” i ndryshuar.**

Përsa i përket, pretendimeve të kontrolluesit **“IDRA Research & Consulting”, SH.A, Tiranë**, ligjërisht vlerësoj:

1-Në lidhje me pikën 1, sipas të cilës, ky kontrollues e realizon marrjen e pëlqimit, nëpërmjet bashkëbisedimit, midis anketuesit dhe të anketuerit, neni 3, paragrafi 24 i ligjit Nr. 9887, dt 10/3/2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale” i ndryshuar, shprehet: *“Pëlqimi i subjekteve të të dhënave”, është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qënë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij*”, si dhe neni 6/1, gërma “a”, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, i cili shprehet: *“1. Të dhënat personale përpunohen vetëm:a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;”,* duke zbatuar gjithashtu, në mënyrë rigorozë edhe

aktin nënligjor, Udhëzimin Nr.2, Datë 25/02/2010, për “Detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”, paragrafët 4 dhe 5.

Gjithashtu, përpunimi nga ana e kontrolluesit, i të dhënave sensitive të tilla si më poshtë :

- Jeta seksuale
- Bindje politike
- Përkatësinë fetare

detyron këtë kontrollues, të realizojë marrjen e pëlqimit, në mbështetje dhe të nenit 7, paragrafi 2, gërma “a”, i cili shprehet:

“2)Përpunimi i të dhënave sensitive bëhet vetëm nëse:

a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqiminin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave ”

2-Në lidhje me pikën 2, sipas të cilës, ky kontrollues, pretendon se informon subjektin e të dhënave personale në të njëjtën formë që i merr dhe pëlqimin, pra gjatë bashkëbisedimit apo anketimit, ligjërisht vlerësojmë:

Duke shkuar në arsyetimin ligjor, mbi pëlqimin, edhe informimi duhet të jetë i shkruar, pasi kontrolluesi nuk është një kontrollues i zakonshëm por përpunon të dhëna personale në një gamë të madhe të subjekteve, në vazhdimësi, dhe në fund të fundit gjithë aktiviteti i tij sondazhues apo anketues, mbështetet vetëm tek të dhënat; si i tillë është një kontrollues potencial i të dhënave personale të subjekteve, ndaj vlerësojmë se dhe informimi duhet të jetë shume i detajuar në formë të shkruar, sipas nenit 18. Po sipas nenit 18, paragrafi 1, i cili shprehet:

“1.Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do t'i përpunohen të dhënat personale, për personin që do të përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij”.

Dukë qënë se, ky kontrollues, mbledh një gamë të gjerë të dhënash, dhe jo vetëm, por dhe të dhëna sensitive, gjykojmë se dhe informimi duhet të jetë i shkruar dhe i detajuar, për subjektin e të dhënave personale, kategoria “i anketuar”.

Nuk duhet të lë pa përmendur, edhe faktin se, marrja e pëlqimit dhe informimi në formë të shkruar, ju jep të drejtën palëve, në rast ankimit, të faktojnë mbrojtjen (nga ana e kontrolluesit), në rastin e ankimit nga ana e subjektit të të dhënave personale, dhe gjithashtu subjekti të faktojë objektin e ankimit, në rastin kur ky objekt, do të jetë kryesisht për pëlqimin.

3-Në lidhje me pikën 3, për sa i përket detyrimit për njoftim që duhet të realizojë kontrolluesi pranë KMDP-së, duke pretenduar se: **”IDRA** në përputhje me udhëzimet e ESOMAR, argumenton se kërkimet kane një status të veçantë që i dallon ato nga aktivitetet e marketingut tregtar dhe duhet te përjashtohen nga përgjegjësia për të njoftuar sipas nenit 21 dhe 22 të ligjit Nr. 9887, dt 10/3/2008 **“Per mbrojtjen e te dhenave personale”** i ndryshuar.”, ligjërisht vlerësojmë:

Duke qënë se, **“IDRA Research & Consulting” Sh.p.k.,Tiranë,** është anëtare e ESOMAR, ka detyrimin të zbatoje aktet e kësaj kompanie ndërkombëtare, prej së cilës dhe është certifikuar, për ushtrimin e kryerjes së shërbimit ndaj klientëve, në fushën e anketimeve dhe sondazheve. Një

nga aktet kryesore te ESOMAR, është dhe “*Giude on distinguishing market research from other data collection activities*”, “*Udhëzim mbi studimin e klasifikimit të tregut, nga aktivitetet e tjera të grumbullimit të të dhënave*”, në të cilën janë shprehur, parimet, përcaktimet, veçoritë, ku një vend të rëndësishëm zë dhe mbrotja e të dhënave personale, pasi të dhënat personale, janë një nga elementët kyç në këtë aktivitet të sondazhimit dhe testimi të tregut. Por kjo nuk do të thotë, në asnjë mënyrë, se legjislacioni shqiptar duhet të shpërfillet. Nëse do të bënim një pyetje, se kujt legjislacioni i referohet “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, kur i duhet të paguajë taksat dhe tatimet, nuk do të merrnim një përgjigje të ngjashme më këtë të dhënë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në mbështetje të nenit 21, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, i cili shprehet:

2) “*Përjashtohet nga detyrimi për të njoftuar përpunimin e të dhënave personale, me qëllim mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin ose aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.*”

3) “*Përjashtohet nga detyrimi për të njoftuar përpunimin e të dhënave personale, me qëllim mbrojtjen e institucioneve, të interesave të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomike ose financiarë të shtetit, apo për parandalimin e ndjekjen e veprave penale*”, konstatohet lehtësisht se, kontrolluesi, “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, nuk është në kushtet e nenit 21, paragrafi, 2 dhe 3, si më lart cituam.

- Gjithashtu, çmuj të arsyeshme, **hartimin e një rregulloreje** të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas kushteve dhe legjislacionit në fuqi kombëtar dhe konkretisht, sipas nenit 27, “Masat për sigurinë e të dhënave personale”, paragrafi 2, gërma “c”, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, i cili shprehet:

“2. *Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:*

c) *udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave*”.

Për sa më sipër, konstatohet lehtësisht gama e gjërë e kategorive të të dhënave personale që përpunon, kontrolluesi “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, dhe, pavarësisht masave të ligjëruara, sipas standardeve të ESOMAR, që ky kontrollues i aplikon ato, me autoritetin që më jep ligji, dhe në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, ligjërisht vlerësoj:

1-Kontrolluesi, “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, në formularët që të anketuarit plotësojnë, nuk ka të parashikuar rubrikën që parashikon dhënien e pëlqimit të të anketuarve, sipas neneve 3, paragrafi 24 dhe 6/1, gërma “a”, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

2) Kontrolluesi, “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, në formularët që të anketuarit plotësojnë, nuk ka të parashikuar rubrikën që parashikon informimin e subjekteve të të dhënave, sipas nenit 18, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

3) Kontrolluesi, “*IDRA Research & Consulting*” Sh.p.k.,Tiranë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të nenit 21 i ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar sipas të cilit: “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para

të të dhënave, sipas nenit 18, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

3) Kontrolluesi, **“IDRA Research & Consulting” Sh.p.k.,Tiranë**, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të nenit 21 i ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar sipas të cilit: *“...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit,sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”*.

4) Kontrolluesi, **“IDRA Research & Consulting” Sh.p.k.,Tiranë**, nuk ka një rregullore, sipas parashikimeve të nenit 27, “Masat për sigurinë e të dhënave personale”, paragrafi 2, gërma “c”, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative;

REKOMANDOJ

1) Kontrolluesi, **“IDRA Research & Consulting” Sh.p.k.,Tiranë**, në formularët që të anketuarit plotësojnë, të inkorporojë rubrikën që parashikon informimin e subjekteve të të dhënave, sipas nenit 18, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe të gjejë mënyrën e duhur për marrjen e pëlqimit.

2) Kontrolluesi, **“IDRA Research & Consulting” Sh.p.k.,Tiranë**, duhet të përmbushë detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të nenit 21-23 të ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

3) Kontrolluesi, **“IDRA Research & Consulting” Sh.p.k., Tiranë**, të hartojë rregulloren “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, konform nenit 27, “Masat për sigurinë e të dhënave personale”, paragrafi 2, gërma “c”, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

4) Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 45 ditësh.

5) Kontrolluesi, **“IDRA Research & Consulting” Sh.p.k.,Tiranë**, ka detyrimin për njoftimin me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me plotësimin e këtyre detyrimeve,

6) Me kalimin e këtij afati në rast mospërmbushjeje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale : *”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

